



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 8486/3870/1636 Regjistri
Datë 23.10.2014 regjistrimi

Nr.1751 Vendimi
Datë 22.06.2016

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga gjyqtarët:

Kryesues: Arjan Qafa
Anëtare: Alkelina Gazidedja
Anëtare: Enkelejda Metaliaj(Softa)

-asistuar nga sekretare gjyqësore Besa Llabunishti, në Tiranë në datë 22.06.2016 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen administrative me Nr. 8486/3870/1636 Regjistri, datë 23.10.2014 regjistrimi, me palë ndërgjyqëse:

- PADITËS:** Omer Meçaj, i biri i Myzaferit, lindur më 07.07.1987, lindur e banues në Lagjen “30 Vjetori”, Berat. Person fizik me NIPT K 93204002V, me aktivitet “Bar Bufe”, adresa, Lagja “30 Vjetori”, Berat.
- TE PADITUR:** Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat.
Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë.
- OBJEKTI :** Shfuqizimin e aktit administrativ Njoftim Vlerësimi Tatimor Nr.3804, datë 29.10.2012 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, si dhe vendimit nr.25504/2, datë 26.02.2013 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, Tiranë.
- BAZA LIGJORE:** Neni 31, 32, 153, 324, 328, 331 të K.Pr.Civile, Kodi i Procedurave Administrative dhe neni 109 i Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Gjykata e Shkallës së Parë Berat me vendimin Nr. 622, datë 27.05.2013, ka vendosur:

Pranimin e padisë së paditësit Omer Meçaj.

Shfuqizimin e aktit administrativ "Njoftim Vlerësimi Tatimor nr.3804, datë 29.10.2012 të Drejtorisë Rajonale Tatimore, Berat, si dhe vendimit nr. 25504/2, datë 26.02.2013 i Drejtorisë së Apelit Tatimor, Tiranë.

Shpenzimet gjyqësore në masën 12.000 lekë, të kryera nga paditësi, në ngarkim të te paditurit Drejtorisë Rajonale Tatimore, Berat.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur ankim pala e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Berat dhe rrëzimin e kërkesë padisë, duke parashtruar këto pretendime:

- Akti i konstatimit është firmosur nga vetë subjekti i kontrolluar, Omer Meçaj. Gjoha e vendosur është në përputhje me nenin 122, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".
- Detyrimi për të instaluar dhe përdorur pajisjen fiskale është i përcaktuar qartë në nenin 55 të ligjit nr. 9920/2008 si dhe në Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 dhe në VKM-në nr.781, datë 14.11.2007, të ndryshuar.
- Kontrolli i kryer nga ana e inspektorëve të hetimit, në çdo rast është një "fotografim" i situatës në momentin e kontrollit mbi subjektin, pa i njoftuar dhe i befasishëm për këta të fundit, por gjithmonë në bazë të një Urdhër Shërbimi.
- Akt-Konstatimi është mbajtur në orën 10:30, e konfirmuar kjo edhe nga vetë subjekti në kërkesë padinë e tij, kështu që kuponat e lëshuara para dhe pas momentit të kontrollit, pavarësisht afërsisë në kohë me orën e kontrollit nuk mund të konsiderohen prova të mjaftueshme ligjore për të vërtetuar se, vlerësimi tatimor objekt ankimi është i pasaktë, pasi kuponat tatimore nuk identifikojnë emrin e klientit, apo numrin e tavolinës, për të bërë të mundur lidhjen e emrit të klientit me kuponin tatimor të lëshuar në orën 10:29 dhe 10:32. Këta kupona jo domosdoshmërisht i përkasin tavolinës që është bërë objekt kontrolli nga ana e inspektorëve, duke qenë se lokali në momentin e kontrollit nuk kishte vetëm një tavolinë që po shërbehej, por disa, kështu që këta kupona mund t'i përkisnin edhe këtyre të fundit.
- Gjate procesit gjyqësor në shkallë të parë, tatimpaguesi përmend edhe emrat e klientëve, që gjendeshin në tavolinën objekt kontrolli, deklaratën e tyre noteriale, si dhe ka thirrur në cilësinë e dëshmitarit njërin prej klienteve, emra të cilët nuk janë paraqitur në akt konstatimi dhe në procesverbalin e gjobës, por kjo nuk përbën absolutisht prova të mjaftueshme ligjore për të vërtetuar pretendimet e tatimpaguesit dhe gjithashtu nuk përjashtohet në asnjë rast mundësia e kompromisit midis tyre.
- Vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor është i drejtë dhe në përputhje edhe me nenin 111, pika 4 e ligjit nr.9920/2008.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

në dhomë këshillimi, pasi dëgjoji relatimin e çështjes nga gjyqtari Arjan Qafa, shqyrtoi të gjitha aktet shkresore dhe bisedoi çështjen në tërësi.

V Ë R E N

Se pranë Gjykatës Administrative të Apelit ka ardhur për gjykim çështja administrative me palë dhe objekt të sipërcituar nga Gjykata e Shkallës së Parë Berat, në bazë të ankimit të bërë nga pala e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat. Ky ankim fillimisht është regjistruar në Gjykatën e Apelit Vlorë, në datën 15.07.2013. Kjo gjykatë me vendimin nr. 1297, datë 10.07.2014, bazuar në nenet 4 dhe 7 të ligjit nr.49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", ka shpallur mos kompetencën e saj për gjykimin e kësaj çështjeje duke dërguar aktet për kompetencë gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit për shkak të fillimit të funksionimit të Gjykatave Administrative në datën 04.11.2013, si dhe referuar Vendimit Unifikues Nr. 3, datë 06.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Nga shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumentave, kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit çmon se vendimi nr. 622, datë 27.05.2013 i Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, është rrjedhim i një procesi të zhvilluar në keqinterpretim të dispozitave të ligjit procedural e material dhe në një vlerësim të gabuar të provave e si i tillë duhet ndryshuar duke vendosur rrëzimin e padisë, për rrjedhojë shkaqet e ngritura në ankim nga pala e paditur për rrëzimin e kërkesë padisë, qëndrojnë.

I. Rrethanat e çështjes:

Nga provat e administruara ka rezultuar se, paditësi Omer Meçaj është i regjistruar si person fizik në organet tatimore për ushtrimin e aktivitetit "Bar Kafe", pajisur me Çertifikatë Regjistrimi me NIPT K93204002V. Në bazë të urdhrit të kontrollit nr. 390, datë 18.10.2012 është ushtruar kontroll pranë subjektit Omer Meçaj nga inspektorët tatimorë të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier. Gjatë këtij kontrolli nga ana e inspektorëve tatimor janë nxjerrë Akti i Konstatimit me nr. 0315976 dhe Procesverbali i gjobës me nr. 0071509 datë 18.10.2012. Sipas aktit të konstatimit të hartuar nga inspektorët e kontrollit, rezulton se ky kontroll ka filluar në orën 10:30, subjekti është i pajisur me kasë dhe nuk lëshon kupone tatimore.

Me shkresën e datës 23.10.2012 aktet e mësipërme janë dërguar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat, e cila ka lëshuar Njoftimin për Vlerësim Tatimor nr. 3804 prot., datë 29.10.2012, sipas të cilit është urdhëruar që subjekti i kontrolluar ka për të paguar gjobën në masën 200 000 lekë.

Paditësi duke mos qenë dakort me gjobën e vendosur ka bërë ankim në Drejtorinë e Apelimit Tatimor Tiranë, e cila pas shqyrtimit të ankimit me vendimin nr. 25504/2 prot., datë 26.02.2013

ka vendosur të lërë në fuqi Njoftimin për Vlerësimin për detyrimin tatimor gjobë nr. 3804 datë 29.10.2012, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat për shumën 200 000 lekë.

Sa më sipër, paditësi i është drejtuar gjykatës me kërkesë padi, duke kërkuar sipas objektit të saj. Në gjykim në shkallë të parë, paditësi ka pretenduar se, akti administrativ i palës së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, "Njoftim i vlerësimit tatimore" me nr. 3804, datë 29.10.2012 të Drejtorisë Rajonale Tatimore, Berat, si dhe vendimit nr. 25504/2, datë 26.02.2013 i Drejtorisë se Apelit Tatimor. Tiranë, janë akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin për procedurat tatimore dhe si të tilla ato në bazë të neneve 115 dhe vijues të K.Pr.Administrative si dhe në zbatim të nenit 331 të K.Pr.Civile, duhet të anulohen. Këtë pretendim paditësi e ka bazuar në faktin që vendosja e gjobës për mos lëshim të kuponit tatimor është lëshuar mbi fakte të pa verteta, duke pretenduar se ky fakt nuk ekziston, se kuponi tatimor ka qenë i lëshuar dhe se inspektorët pasi kanë pasur kundërshtime nga një klient për t'i dhënë kuponin që e kishte në dore, kanë vendosur gjobë në ngarkim të tij.

Ndërsa, të paditurit kanë prapësuar se, kontrolli është ushtruar në përputhje me ligjin dhe Urdhrin e Shërbimit nr. 390 datë 18.10.2012. Kontrolli i ushtruar është fotografim i momentit të ushtrimit të kontrollit dhe në lokal janë gjetur tavolina që u është shërbyer pa kupon tatimor si dhe fakti që paditësi ka prerë kupona tatimore në orën e kontrollit nuk do të thote se ai nuk ka pasur më parë klientë të cileve nuk u ka lëshuar kupon tatimor.

II. Vendimi dhe arsyetimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Berat:

Në analizë të pretendimeve të parashtuara në kërkesë padi, të provave e akteve shkresore të administruara dhe rrethanave të faktit e të ligjit, Gjykata ka vlerësuar se, padia e paraqitur prej paditësit është e bazuar në ligj dhe në prova, ndaj ka disponuar me pranimin e saj, duke arsyetuar se:

"Nga tërësia e provave të administruara në seance gjyqësore rezulton se si rrjedhojë e një procesi administrative, i padituri është dënuar me një gjobë për kundravajtje administrative në masën 200 000 lekë, me arsyetimin se gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij ekonomik në kundërshtim me ligjin dhe konkretisht në bazë të nenin 122 pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Siç shikohet nga argumentimi i mësipërm, paditësi është dënuar pas një procesi administrativ me gjobë për kryerje të kundravajtjes administrative, vepër kjo që në thelb duhet të përmbajë të gjithë elementët e kundravajtjes që janë objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive dhe që organi kompetent administrativ ka barrën e provës që t'i provojë subjektit të kësaj kundravajtje, se ai me veprime ose mosveprime të kundraligjshme ka kryer kundravajtjen.

Në rrethana të tilla i padituri konsideron provë të plotë aktin e konstatimit që sipas tij është një fotografim i momentit të kontrollit ku ka rezultuar siç pasqyron ky akt. Nga tërësia e shpjegimeve dhe e "fotografimeve" që ky akt sjell, gjykata çmon se akti nuk provon se i dënuari me gjobë e ka konsumuar kundravajtjen për të cilën ai është dënuar.

Akte Konstatimi i kundravajtjes, tregon se në orën 10:30 në lokalën e paditësit, është ushtruar kontrolli, se subjekti është i regjistruar, se subjekti është i pajisur me kasë fiskale dhe nuk lëshon kupone tatimore. Ky që në gjykim nga i padituri konsiderohet si "Fotografim" i momentit të kontrollit, në këtë formë se si ai e ka përshkruar gjendjen, gjykata çmon se është "Fotografimi" më i keq i mundshëm që të pasqyrojë se subjekti është kapur në kundravajtje administrative. Akti në fjalë nuk pasqyron se sa tavolina ka subjekti, sa prej tyre kanë klientë dhe në sa nuk kanë dhe në cilat tavolina subjekti nuk ka lëshuar kupona tatimore. Po kështu, ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, parashikon se në këtë rast është në kundravajtje administrative edhe klienti i cili gjatë blerjes me para në dorë, nuk merr nga shitësi kuponin tatimor. Për të provuar këtë situatë të paligjshme, në rastin konkret duhet të identifikonin edhe kundravajtësit, Klientë me emër dhe mbiemër dhe duhet që edhe ata të përgjigjeshin sipas ligjit. Deklarimi në aktin e konstatimit si dhe në procesverbalin e gjobës se subjekti nuk lëshon kuponin tatimor gjykata çmon se është një deklaram i pa mbështetur në prova, prandaj dhe gjykata çmon se akti administrativ i lëshuar në bazë të këtij deklarami është i pavlefshëm dhe duhet të anulohet.

Në gjykim, nga shiriti i kasës fiskale të subjektit të gjobitur rezulton se paditësi në datën e kontrollit para dhe pas orës së kontrollit ka lëshuar fatura tatimore në mënyrë të rregullt dhe periodike dhe konkretisht kishte përpara fillimit të kontrollit nga shiriti rezulton se janë lëshuar faturat tatimore nr.17; 18; 19; 20; 21; 22; dhe menjëherë pas fillimit të kontrollit është lëshuar fatura nr.23. Siç edhe shihet nga intesiteti i lëshimit të faturave, nga lloji dhe sasia e personave të shërbyer, ku bëhet fjalë për shërbime me kafe dhe ndaj shumë personave për një interval kohe prej 10 minutash nga një kamarjere dhe një banak ku është në punë vetëm një ekspres rezulton të jenë lëshuar fatura tatimore nëpërmjet kasës, gjithësej 7 të tilla në një interval kohor prej 10 minutash, nga të cilat rezulton se janë shërbyer vetëm pije të nxehta të realizuara nëpërmjet ekspresit që janë kafe dhe makjato. Siç edhe shihet, ka një maksimum faturimi në raporte me mundësinë e shërbimit nëpërmjet ekspresit.

Kjo provë po të shikohet në harmoni dhe me dëshminë përpara kësaj gjykate të deshmitarit Gjergji Dallenga, atëherë situata e pretenduar nga paditësi rezulton tërësisht e vërtetuar dhe gjoba është vendosur nga inspektorët për situatën e refuzimit të përgjigjes nga klienti Dallenga ndaj inspektorëve dhe paaftësia e tyre për të kryer detyrën, në përputhje me ligjin.

Te gjitha provat e mësipërme flasin qartë se paditësi nuk ka kryer kundravajtje administrative, për të cilin është lëshuar akti administrativ "Njoftim Vlerësimi Tatimor" nr. nr.3804, datë 29.10.2012 të Drejtorisë Rajonale Tatimore, Berat, si dhe vendimit nr. 25504/2, datë 26.02.2013 i Drejtorisë së Apelit Tatimor, Tiranë, i cili e ka lënë në fuqi atë dhe për këto arsye këto akte gjykata çmon t'i shfuqizojë tërësisht në bazë të nenin 331/3 të K.Pr.Civile."

III.Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

Në analizë të ankimeve të paraqitura nga pala e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat, ndaj vendimit objekt ankimi, dhe në analizë të akteve të dosjes si dhe në referim të përcaktimeve të ligjit material dhe procedural që gjen zbatim në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit çmon se: Vendimi nr. 622, datë 27.05.2013 i Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, është

rrjedhim i një procesi të zhvilluar në keqinterpretim të dispozitave të ligjit procedural dhe në një vlerësim të gabuar të provave e si i tillë duhet ndryshuar duke vendosur rrëzimin e padisë.

Së pari gjykata vlereson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7 gërma "a", nenit 10 paragrafi 2 gërma "a" dhe nenit 44 të Ligjit Nr. 49/2012, kjo gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

Së dyti vlerëson të marrë në shqyrtim kushtet e pranueshmërisë së ankimit. Sikurse është referuar edhe më sipër në këtë vendim, rezulton që vendimi të jetë shpallur në datën 27.05.2013. Pala e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat, ka paraqitur ankim në datën 11.06.2013, (*pala e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat ka marrë dajeni më datë 10.06.2013 me shërbim postar*), pra dukshëm brenda afatit pesëmbëdhjetë ditor, të përcaktuar në nenet 443 paragrafi i parë dhe 444 paragrafi i parë të K.Pr.Civile. Po kështu, nuk rezulton të ekzistojnë kriteret penguese të parashikuara në nenin 45 të ligjit nr. 49/2012 që e bëjnë vendimin të paankimueshëm. Ankimi rezulton të jetë i plotë edhe në elementët e tjerë, si në elementët e formës edhe të përmbajtjes, lidhur me nënshkrimin nga pala që e ka paraqitur, tregimin e palëve ndërgjyqëse, vendimin kundër të cilit është paraqitur ankim, apo kërkimet për të cilat ai është paraqitur. Për të gjitha sa më sipër gjykata çmon se ankimi i paraqitur kundër vendimi nr. 622, datë 27.05.2013 i Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, objekt gjykimi, duhet të pranohet për shqyrtim.

Së treti lidhur me pretendimet e parashtruara në ankim nga pala e paditur, referuar fakteve të mësipërme, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se janë të bazuara në ligj e prova.

Siç ka rezultuar nga provat e administruara në gjykim, paditësi Omer Meçaj është i regjistruar si person fizik në organet tatimore për ushtrimin e aktivitetit "Bar Kafe", pajisur me Çertifikatë Regjistrimi me NIPT K93204002V. Në baze të urdhrin të kontrollit nr. 390, datë 18.10.2012 është ushtruar kontroll pranë subjektit Omer Meçaj nga inspektorët tatimor të Drejtorisë Rajonale Tatimorë. Gjate këtij kontrolli nga ana e inspektorëve tatimorë janë nxjerrë Akti i Konstatimit me nr. 0315976 dhe Procesverbali i gjobës me nr. 0071509 datë 18.10.2012. Sipas aktit të konstatimit të hartuar nga inspektorët e kontrollit, rezulton se ky kontroll ka filluar në orën 10:30, subjekti është i paisur me kasë dhe nuk lëshon kupone tatimor.

Me shkresën e datës 23.10.2012 aktet e mësipërme janë dërguar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat, e cila ka lëshuar Njoftimin për Vlerësim Tatimor nr. 3804 prot., datë 29.10.2012, sipas të cilit është urdhëruar që subjekti i kontrolluar ka për të paguar gjobën në masën 200 000 lekë.

Paditësi duke mos qenë dakord me gjobën e vendosur, ka bërë ankim në Drejtorinë e Apelimit Tatimor Tiranë, e cila pas shqyrtimit të ankimit me vendimin nr. 25504/2 prot., datë 26.02.2013 ka vendosur të lërë në fuqi Njoftimin për Vlerësimin për detyrimin tatimor gjobe nr. 3804 datë 29.10.2012, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat për shumën 200 000 lekë.

Konstatohet se gjithë pretendimeve të paraqitura në ankim ndaj vendimit nr. 622, datë 27.05.2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë Berat nuk u është dhënë zgjidhje në vendim. Ky

vendim konstatohet të jetë rrjedhojë e një analize jo të drejtë të provave dhe të rrethanave të faktit e të ligjit.

Gjykata Administrative e Apelit çmon se: Gjykata Shkallës së Parë Berat, ka gabuar në interpretimin dhe vendimin e saj, duke e pranuar plotësisht kërkesë padinë e palës paditëse. Kolegji Administrativ i Apelit vlerëson se inspektorët tatimorë të Drejtorisë Rajonale Tatimorë Fier, me cilësinë e palës paditëse legjitimohen sipas urdhrit të kontrollit nr. 390, datë 18.10.2012, për të kryer kontrollin tatimor në zonën ku ka vendndodhjen subjektit Omer Meçaj . Inspektorët kanë detyrim të konstatojnë me shkrim kundravajtjen administrative në prezencë të palëve. Gjatë këtij kontrolli nga ana e inspektorëve tatimor janë nxjerrë Akti i Konstatimit me nr. 0315976 dhe Procesverbali i gjobës me nr. 0071509 datë 18.10.2012. Sipas aktit të konstatimit të hartuar nga inspektorët e kontrollit, rezulton se ky kontroll ka filluar në orën 10:30, subjekti është i pajisur me kasë dhe nuk lëshon kupone tatimore. Me shkresën e datës 23.10.2012, aktet e mësipërme janë dërguar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat, e cila ka lëshuar Njoftimin për Vlerësim Tatimor nr. 3804 prot., datë 29.10.2012, sipas të cilit është urdhëruar që subjekti i kontrolluar ka për të paguar gjobën në masën 200 000 lekë.

Në këto kushte Gjykata Administrative e Apelit vlerëson të drejtë Aktin e Konstatimit me nr. 0315976, Procesverbalin e gjobës me nr. 0071509 datë 18.10.2012 dhe shkresa Njoftim për Vlerësim Tatimor të datës 23.10.2012 me nr. 3804 prot., datë 29.10.2012, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat në të cilën ka detyruar palën paditëse për të paguar gjobën në masën 200 000 lekë, pasi janë akte të nxjerrë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9920/2008.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson të gabuar arsyetimin e bërë nga Gjykata Shkallës së Parë Berat, kur ka konkluduar se veprimet e palës së paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat, janë të pa drejta në lidhje me mosmarrëveshjen e krijuar me palët duke i justifikuar me thirrjen e provave me dëshmitarë në kundërshtim me nenin 232 të K.Pr. Civile. Në të cilin

“Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë. Gjithashtu, nuk lejohet të provohet me dëshmitarë marrëveshja e palëve për ndryshimin e kontratës ose shuarja, me anë të pagimit ose të faljes së detyrimeve në të holla, që rrjedhin nga një kontratë e bërë me dokument”.

Ndryshe nga sa ka vlerësuar Gjykata Shkallës së Parë Berat, ky kolegji bën një rivlersim të ri të provave dhe të fakteve të vlerësuara nga kjo gjykatë duke i vlersuar si të ligjshme aktin administrativ të Konstatimit me nr. 0315976, Procesverbalin e gjobës me nr. 0071509 datë 18.10.2012 dhe shkresën Njoftim për Vlerësim Tatimor të datës 23.10.2012 me nr. 3804 prot., datë 29.10.2012.

Në këto kushte, Gjykata Administrative e Apelit bën një analizë të plotë akteve të administruara dhe të pretendimeve të ngritura nga palët, çmon se në rastin konkret konkluzionet e arritura nga Gjykata e Shkallës së Parë Berat janë të gabuara dhe si të tilla duhen rrëzuar duke ndryshuar mënyrën e disponimit të kësaj gjykate lidhur me padinë dhe rrëzimin e saj, si të pabazuar në ligj dhe prova.

Për të gjitha sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson si të bazuara në ligj e prova pretendimet e parashtruara në ankim, dhe si të tilla, vendimi nr. 622, datë 27.05.2013, i Gjykata

Shkallës së Parë Berat, është marrë në analizë të gabuar të provave, e në keqinterpretim të dispozitave të ligjit procedural e material , prandaj duhet ndryshuar, duke vendosur rrëzimin e padisë. Referuar nenit 50 gërma "c" të ligjit nr.49/2012, kjo Gjykatë vlerëson se duhet ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50, shkronja "c" e ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

VENDOSI

Ndryshimin e vendimit nr.622, datë 27.05.2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj.

Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

U shpall në Tiranë, sot më datë 22.06.2016.

ANËTARE

Enkelejda METALIAJ (SOFTA)
DV

ANËTARE

Alkelina GAZIDEDJA
DV

KRYESUES

Arjan Qafa
DV

E NJEHSUAR ME ORIGINALIN

Kancelari
Leonard Shkedy
Shkedy